



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



**UDHËRRËFYESI PËR KOORDINIMIN
NDËRINSTITUCIONAL DHE
KOHERENCËS PËR QEVERISJEN E
MIGRACIONIT**

2021

NËNTOR
2021

**UDHËRRËFYESI
PËR KOORDINIMIN
NDËRINSTITUCIONAL
DHE KOHERENCËS PËR
QEVERISJEN E
MIGRACIONIT**





Ky udhërrëfyes është hartuar në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Migracionit, nga Sekretariati Teknik i Migracionit.

Procesi i hartimit është mbështetur nga bashkëpunimi gjerman GIZ, programi Diaspora dhe Migracioni.

PËRMBAJTJA



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
METODOLOGJIA E HARTIMIT TË UDHËRRËFYESIT	3
A) Studimi dhe vlerësimi i kuadrit politik, ligjor dhe strategjik.....	3
B) Vlerësimi i objektivave, masave dhe treguesve sipas institucioneve të SKM dhe PV 2019-2022	5
C) Fokus Grupet me institucionet përgjegjëse dhe zbatuese të masave të SKM-së.....	5
PJESËMARRJA E INSTITUCIONEVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE	5
OBJEKTIVI STRATEGJIK A	6
OBJEKTIVI STRATEGJIK B	9
OBJEKTIVI STRATEGJIK C	13
OBJEKTIVI STRATEGJIK D.....	18
MONITORIMI DHE RAPORTIMI	24
Pikat e kontaktit për raportimet periodike	25
Formati i raportimit.....	27

1.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2022-2026

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kuadri ligjor shqiptar gjatë viteve të fundit ka qenë në një linjë me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) dhe ka synuar ndërtimin e një politike migratore sa më të fortë dhe koherente. Për këtë arsye aktet në zbatim të tij janë përmirësuar jo vetëm në aspektin e procedurave të dokumenteve të udhëtimit, vizave, punësimit, qëndrimit, bashkimit familjar, por edhe në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të të gjithë migrantëve dhe familjeve të tyre, rezultati i të cilës arrihet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit sa më efikas ndërinstitucional.

Gjithashtu, politikat migratore të Republikës së Shqipërisë përfshijnë politikat imigratore dhe emigratore, të shprehura në normativën migratore të vendit, e cila është në përputhje edhe me politikën dhe normativën migratore të BE-së, të cilat synojnë:

- i. Minimizimin e kostove nga migracioni i parregullt;
- ii. Maksimizimin e përfitimeve nga migracioni i rregullt;
- iii. Garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të migrantëve;
- iv. Luftën kundër migracionit të paligjshëm;
- v. Nxitjen e kthimit vullnetar;
- vi. Mbështetjen e lidhjes ndërmjet migrimit dhe zhvillimit të vendit;
- vi. Menaxhimin e flukseve imigratore.

Arritja e këtyre synimeve kërkon një qasje ndërsektoriale ndaj qeverisjes së migracionit. Njëhapirëndësishëm drejt arritjes së një politike

gjithëpërfshirëse të qeverisjes së migracionit ishte miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), 2016–2020. Në përputhje me vizionin strategjik të SKZHI-së, “për të krijuar një sistem efektiv të qeverisjes të migracionit në Shqipëri”, qeveria shqiptare **me vendimin nr. 400, datë 19.6.2019 miratoi “Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019–2023”**.

Dokumentet strategjike për qeverisjen e migracionit të miratuara deri më tani kanë treguar rëndësinë që ka forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin efektiv të migracionit. Mësimet e nxjerra nga përpjekjet e kaluara tregojnë nevojën për forcimin e mëtejshëm të angazhimit institucional në qeverisjen e migracionit, e cila mund të arrihet përmes të mësuarit në vazhdimësi, ndarjes së praktikave më të mira, përfshirjes aktive në hartimin dhe zbatimin e politikave të migracionit dhe programeve zbatuese, masave programuese, përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e migracionit, pjesëmarrjes të rregullt në forumet ndërkombëtare në fushën e migracionit dhe monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të progresit të arritur.

Në nivelin ndërinstitucional, përgjegjësia e institucioneve në menaxhimin e çështjeve migratore ka ardhur duke u rritur, ku detajimi i përgjegjësisë së autoriteteve përgjegjëse për trajtimin e të huajve, është përcaktuar në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”.

Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri, është një nga katër objektivat kryesorë të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin. Për të përmbytur këtë detyrim, ndër të tjera synohet përmirësimi i mekanizmave të koordinimit për qeverisjen e migracionit, veçanërisht i koherencës horizontale dhe vertikale përmes koordinimit të përmirësuar operacional dhe strategjik.

Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri, është një nga katër objektivat kryesorë të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin. Për të përmbushur këtë detyrim, ndër të tjera synohet përmirësimi i mekanizmave të koordinimit për qeverisjen e migracionit, veçanërisht i koherencës horizontale dhe vertikale përmes koordinimit të përmirësuar operacional dhe strategjik.

Gjithashtu, një faktor kyç në rritjen e pronësinë institucionale mbi qeverisjen e migracionit është përcaktimi i qartë i roleve dhe i përgjegjësi të institucioneve për qeverisjen e migracionit në nivel qendror dhe në nivel vendor dhe akoma më tepër përcaktimi dhe ndarja e qartë e detyrave dhe kompetencave të institucioneve, si dhe të pikave të kontaktit/personave përgjegjës për zbatimin dhe raportimin mbi SKM.

Dokumentet strategjike për qeverisjen e migracionit të miratuara deri më tani, kanë treguar rëndësinë që ka forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin efektiv të migracionit. Prandaj duhet t'i kushtohet vëmendje shpeshtisë së takimeve ndërinstucionale për monitorimin e zbatimit të SKM-së dhe të udhërrëfyesit ose për trajtimin e çështjeve specifike të koordinimit në fushën e migracionit, si edhe ndryshimeve të realizuara në organizimin e shërbimeve për migrantët, të kryera çdo vit.

Mësimet e nxjerra nga përpjekjet e kaluara tregojnë nevojën për forcimin e mëtejshëm të angazhimit institucional në qeverisjen e migracionit, e cila mund të arrihet përmes të mësuarit në vazhdimësi, ndarjes së praktikave më të mira, përfshirjes aktive në hartimin dhe zbatimin e politikave të migracionit dhe programeve zbatuese, masave programuese, përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e migracionit, pjesëmarrjes të rregullt në forumet ndërkombëtare në fushën e migracionit dhe monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të progresit të arritur.

Për këtë arsye udhërrëfyesi është dokumenti i përcaktimit të procedurave standarde dhe rregullimit të mënyrës së ndërveprimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, hartimi i të cilit ndihmon koordinimin ndërinsticional dhe koherencën për qeverisjen e migracionit, duke garantuar një proces të mirëpërcaktuar dhe të vazhdueshëm të zbatimit dhe monitorimit të këtij dokumenti.

Do të organizohen takime periodike çdo tre muaj nga Sekretariati Teknik i Migracionit me pikat e kontaktit për monitorimin e zbatimit të udhërrëfyesit, për trajtimin e çështjeve specifike të koordinimit në fushën e migracionit dhe ndryshimet e realizuara në organizimin e shërbimeve për migrantët të kryera çdo vit.



2.

METODOLOGJIA E HARTIMIT TË UDHËRRËFYESIT

A) STUDIMI DHE VLERËSIMI I KUADRIT POLITIK,
LIGJOR DHE STRATEGJIK.

METODOLOGJIA E HARTIMIT TË UDHËRRËFYESIT

A) STUDIMI DHE VLERËSIMI I KUADRIT POLITIK, LIGJOR DHE STRATEGJIK.

Kuadri politik për menaxhimin e migracionit

Politikat migratore të Republikës së Shqipërisë, si politikat imigratore dhe ato emigratore, janë në përputhje edhe me politikën dhe normativën migratore të BE-së, për garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të migrantëve, luftën kundër migracionit të paligjshëm, përfitimet e mundshme nga migracioni i rregullt, mbështetjen e lidhjes ndërmjet migrimit dhe zhvillimit të vendit kryesisht nëpërmjet investimeve të diasporës, nxitjen e kthimit vullnetar dhe menaxhimin e flukseve imigratore.

Kuadri Strategjik Kombëtar që ndikon në qeverisjen efektive të migracionit

- Planet i Veprimit për Remitancat 2007-2010
 - Strategjia për Kthimin dhe Riintegrimin e Qytetarëve Shqiptarë 2010-2015)
 - Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Fëmijëve 2014-2017
 - Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2014-2020 dhe Plani i Veprimit
 - Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillim Rural 2014-2020
 - Strategjia për Biznesin dhe Investimet 2014-2020
 - Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe Përfshirjen Sociale 2019-2022
 - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (NSDI) 2016-2020
 - Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025
 - Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2018-2020
 - Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019-2022.
- Legjislacioni bazë kombëtar për migracionin përbëhet nga aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:
- **Ligji nr. 79/2021 “Për të huajt”**, shënon një përmirësim të mëtejshëm të normës së migracionit për të huajt, duke e harmonizuar atë pjesërisht me legjislacionin e BE-së në këtë fushë, për aq sa i kërkohet Shqipërisë në pozicionin e saj aktual, por edhe duke pasur parasysh perspektivën e afërt të proceseve integruese.
 - **Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”**
 - **Ligji nr. 113/2020, “Për shtetësinë”**.
 - **VKM nr. 513, datë 13.6.2013**, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - **VKM nr. 265, datë 7.5.2014**, “Për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune ose çertifikatë regjistrimi të punësimit për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë me përkatësi etnike shqiptare”.
 - **VKM-të nr. 76, 77, 70, 69, 68, 67, 66, 85, 84, 83, 82, 81, 80, 79, 78 dhe 74**, datë

12.2.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin dhe heqjen e “lejes së punës”, ku përfshihen të gjitha llojet e punësimit për shtetasit e huaj.

- **VKM nr. 384, datë 27.6.2018**, “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 70, datë 12.2.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurës për marrjen e çertifikatës së regjistrimit në punë”.

Gjithashtu, korniza ligjore për migracionin përbëhet nga urdhra dhe udhëzime të miratuara për plotësimin e këtij kuadri ligjor.

B) Vlerësimi i objektivave, masave dhe treguesve sipas institucioneve të SKM dhe PV 2019-2022

C) Fokus Grupet me institucionet përgjegjëse dhe zbatuese të masave të SKM-së

- Vlerësimi i praktikave të punës në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin ndërinstitucional ndërmjet Sekretariatit Teknik dhe pikave të kontaktit
- Adresimi për zgjidhje të mangësive të evidentuara në rrugën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve.



3.

PJESËMARRJA E INSTITUCIONEVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE

PJESËMARRJA E INSTITUCIONEVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019-2022, është organizuar dhe orientuar në katër objektiva specifike, të ndara në nënobjektiva dhe masa konkrete sipas institucioneve përgjegjëse. Në këtë këtë kontekst, Ministria e Brendshme është lider për zbatimin e kësaj strategjie për shkak të fushës së përgjegjësive së saj që mbulon çështjet e migracionit.

Çdo objektiv strategjik është i paraqitur

në tabelë të detajuar, duke përcaktuar nënobjektivat specifike, rezultatet që duhet të dalin nga zbatimi i secilit nënobjektiv, masat nëpërmjet të cilave prodhohen këto rezultate, si edhe institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për secilën masë.

Në fund, në tërësinë e komplet objektivave strategjik A, B, C, D paraqitet ajo që duhen të arrihet nga zbatimi i masave konkrete sipas nënobjektivave.

4.

OBJEKTIVI STRATEGJIK A

2022-2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK A

GARANTIMI I QEVERISJES STRATEGJIKE TË MIGRACIONIT NË SHQIPËRI.

Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri do të arrihet nëpërmjet realizimit të nënobjektivave të përmirësimit të mekanizmave të koordinimit për qeverisjen e migracionit, forcimit e rritjes së kapaciteteve institucionale apo partneriteteve për qeverisjen e migracionit, si dhe përafrimit të kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe ndërkombëtar për qeverisjen e migracionit.

Në këtë drejtim, janë përcaktuar organet kompetente të monitorimit dhe ndërveprimit për mirë-qeverisjen e migracionit, si dhe organet vendimmarrëse, të cilat ndikojnë në përmirësimin e koherencës horizontale dhe vertikale përmes koordinimit më të mirë operacional dhe strategjik, me qëllim zbatimin e suksesshëm të strategjisë dhe koordiniminin

e qeverisjes së migracionit në Shqipëri.

Ky objektivi do të arrihet edhe nëpërmjet qartësimit të kompetencave të institucioneve dhe agjencive kryesore të Republikës së Shqipërisë që veprojnë në fushën e migracionit, duke identifikuar në të njëjtën kohë dhe nevojat për përmirësimin e kapaciteteve të tyre, të cilat nëpërmjet trajnimeve të duhura do të rezultojnë në rritjen e nivelit të stafit për të siguruar koordinimin sa më efektiv dhe zbatimin e suksesshëm të strategjisë.

Gjithashtu, qeverisja strategjike e migracionit do të realizohet dhe nëpërmjet përafrimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe ndërkombëtar për qeverisjen e migracionit, për të përmbushur miratimin dhe zbatimin sistematik të termave, normave dhe standarteve ndërkombëtare në fushën e migracionit.

A.Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri				
Nënobjektiva	Rezultate të pritëshme për nënobjektivin	Masa total 22	Lider	Mbështetur
A1. Përafrimi i kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe ndërkombëtar për qeverisjen e migracionit	R.1 Miratimi dhe zbatimi sistematik i termave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e migracionit	3	MB 3	MEPJ, MFE, MSHMS, MASR, MSHD, MD, IOM, DBE
A2. Rritja e kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit	R.1 Qartësimi i kompetencave të institucioneve & agjencive kryesore shqiptare dhe identifikimi i kapaciteteve të tyre për qeverisjen e migracionit R.2 Përmirësimi i mbledhjes, analizimit dhe ndarjes së të dhënave për migracionin	10	MB 5	DAP, ASPA, INSTAT, AKD/MSHD, IOM
			INSTAT 2	IOM, DBE, MB
			MFE 1	AKPA/MFE, ADISA
			DKM 1	INSTAT, DBE
ASPA 1	INSTAT, MB, IOM, DBE			
A3. Përmirësimi i mekanizmave të koordinimit për qeverisjen e migracionit	R.1 Përmirësimi i koherencës horizontale dhe vertikale përmes koordinimit të përmirësuar operacional dhe strategjik	5	MB 5	Kryeministria, IOM dhe Ministrinë e linjës, Bashkitë, Komunitat, Aktorët e Shoqërisë Civile, Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave
A4. Forcimi i partneriteteve për qeverisjen e migracionit	R.1 Rishikimi i partneriteteve ekzistuese institucionale për migracionin dhe formulimi i partneriteteve të reja	4	MB 4	Ministrinë e linjës, Aktorë të tjerë në fushën e Migracionit.
Treguesit e Rezultateve për objektivin e strategjik A:	Përafrimi 100% i kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe atë ndërkombëtar për migracionin; niveli i duhur i stafit për të siguruar zbatimin e suksesshëm dhe koordinimin e qeverisjes së migracionit; numri i partneriteteve të reja me aktorët joqeveritarë për mirëqeverisjen e migracionit			

5.

OBJEKTIVI STRATEGJIK B

2022-2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK B

B. Garantimi i migracionit të sigurt dhe të rregullt nga, përmes dhe drejt Shqipërisë

Garantimi i migracionit të sigurt dhe të rregullt do të arrihet nëpërmjet realizimit të nën-objektivave specifik si: trajtimi në mënyrë të efektshme i lëvizjeve të parregullta në kufijtë e shtetit dhe në brendësi të territorit të Shqipërisë, përmirësimi i efektshmërisë së mekanizmave të kthimit në vendin e origjinës për shtetasit e huaj, reagimi me efikasitet ndaj migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë në vendet anëtare të BE-së, menaxhimi i flukseve të përziera.

Duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme infrastrukturën në kufij apo mekanizmat e kthimit, si dhe duke minimizuar rastet e qëndrimit të parregullt dhe tranzitimit, përmes kontrollit të ligjshmërisë së qëndrimit, marrjes së masave në rastet e provuara të shkeljes së ligjshmërisë së qëndrimit, dhe përmes ofrimit të informacionit të duhur, do të arrihet në sigurimin dhe forcimin e kontrollit të migra-

cionit për trajtimin në mënyrë të efektshme të lëvizjeve të parregullta në kufijtë e RSH-së, për të kapur rastet e migrantëve të parregullt dhe për kthimin e tyre në vendet e origjinës përmes ripranimit dhe kthimit vullnetar.

Garantimi i migracionit të rregullt do të realizohet nëpërmjet reagimit ndaj migracionit të parregullt të atyre shtetasve shqiptarë që migrojnë drejt vendeve anëtare të BE-së, duke zbatuar të gjitha masat e duhura për parandalimin e këtij fenomeni, si dhe duke realizuar mbështetjen e duhur për kthimin dhe riintegrimin e tyre në Shqipëri.

Gjithashtu, migracioni i rregullt kërkon zhvillimin e kuadrit strategjik dhe operacional të gjitha strukturave përkatëse në si në kufi por edhe në nivelin qëndror e vendor, për të menaxhuar në mënyrë sa më efektive e për të përballuar sfidat e flukseve të përziera drejt Shqipërisë, kjo dhe me qëllim trajtimin e rasteve të mundshme të migrantëve që u përka-sin veçanërisht kategorive vulnerabël, duke i referuar tek shërbimet e duhura të mbrojtjes.

B. Garantimi i migracionit të sigurt dhe të rregullt nga, përmes dhe drejt Shqipërisë

Nënobjektiva	Rezultate të pritëshme për nënobjektivin	Masa total 31	Lider	Mbështetur
B1 Trajtimi në mënyrë të efektshme i lëvizjeve të parregullta në kufijtë dhe në brendësi të territorit të Shqipërisë	R.1 Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës në kufij dhe brenda territorit për të forcuar kontrollin e migracionit duke ruajtur të drejtat e migrantëve	15	DKM / MB 12	MEPJ, MFE, MSHMS, MASR, MSHD, MD, IOM, DBE
	R.2 Sigurimi i efikasitetit të punonjësve të kufirit		MEJP 3	DKM/MB
	R.3 Minimizimi i rasteve të qëndrimit të parregullt dhe tranzitimit, përmes kontrollit të ligjshmërisë së qëndrimit, marrjes së masave në rastet e provuara të shkeljes së ligjshmërisë së qëndrimit, dhe përmes ofrimit të informacionit			
B2 Përmirësimi i efektshmërisë së mekanizmave të kthimit në vendin e origjinës për shtetasit e huaja	R.1 Kthimi i suksesshëm i shtetasve të huaj në vendet e tyre të origjinës përmes riprimit dhe kthimit vullnetar	6	MB / DKM 6	MEJP, IOM
B3 Reagimi me efikasitet ndaj migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë drejt vendeve anëtare të BE-së	R.1 Zbatimi i masave të duhura për parandalimin e migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë R.2 Mbështetja për kthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të ripranuar	5	MB 5	Kryeministria, IOM dhe Ministritë e linjës, Bashkitë, Komunitat, Aktorët e Shoqërisë Civile, Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave
B4 Menaxhimi i efektshëm i flukseve të përziera	B4.1 Zhvillimi i kuadrit strategjik dhe operacional për të përballuar sfidat e flukseve të përziera drejt Shqipërisë	5	MB 4	Ministritë e linjës, Aktorë të tjerë në fushën e Migracionit.
Treguesit e Rezultateve për objektivin e strategjik B:	% e rritjes së migrantëve të parregullt të kapur në kufi dhe në territor; % e kategorive vulnerabël të migrantëve të identifikuar me anë të procedurave të përzgjedhjes dhe të referuar tek shërbimet e mbrojtjes, përfshirë edhe në kohë krize; numri i shtetasve shqiptarë të ripranuar që janë referuar tek shërbimet e riintegrimit; numri i shtetasve të vendeve të treta të kthyer në vendet e tyre të origjinës përmes riprimit ose kthimit vullnetar			

6.

OBJEKTIVI STRATEGJIK C

2022-2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK C

C. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik kombëtar dhe vendor

Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi do të arrihet nëpërmjet realizimit të nënobjektivave kryesisht për sigurimin e kuadrit të efektshëm të politikave të migracionit për këtë motiv, lehtësimin e migracionit sezonal dhe qarkullues për shtetasit shqiptarë, si dhe maksimizimit të ndikimit të migracionit tek zhvillimi kombëtar dhe vendor.

Sigurimi i kuadrit të efektshëm të politikave të migracionit për motive punësimi do arrihet fillimisht nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të kuadrit rregullator dhe institucional për migracionin e punës. Mbështetur kjo nga konsiderimi i dinamikave të migracionit të shtetasve shqiptarë në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e këtyre politikave, si dhe nëpërm-

jet skemave proaktive që synojnë të tërheqin shtetas shqiptarë, anëtarë të diasporës shqiptare, por dhe të huaj me aftësi dhe kualifikime për të cilat oferta është e ulët në tregun shqiptar të punës.

Për të lehtësuar migracionin sezonal dhe qarkullues për shtetasit shqiptar, do të punohet për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për migracionin e punës, sigurimin e ofrimit të shërbimeve përpara nisjes për punëtorët migrantë shqiptarë të mundshëm, si dhe për forcimin e kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe lehtësimin e kthimit dhe riintegritit socio-ekonomik të shtetasve shqiptarë.

Zhvillimi në mënyrë të efektshme i politikave e masave sa më sipër, promovimi i kanaleve formale dhe përdorimi produktiv të remitancave, si dhe promovimi i investimeve në Shqipëri, do të ndikojnë dhe në zhvillimin kombëtar e vendor të vendit tonë.

C: Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/vendor				
Nënobjektiva	Rezultate të pritëshme për nënobjektivin	Masa total 41	Lider	Mbështetur
C.1 Nën-Sigurimi i kuadrit të efektshëm të politikave të migracionit për motive punësimi	R.1 Konsiderimi i dinamikave të migracionit të shtetasve shqiptarë në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kombëtare të punësimi	16	MFE 10	AKPA, IOM, MB, MSHD, Të ketë konsultime me shoqata të punëdhënësve për të vlerësuar, Të gjitha ministritë e linjës, MEJP.
	R.2 Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe skemave proaktive që synojnë të tërheqin shtetas shqiptarë, anëtarë të Diasporës shqiptare, dhe të huaj me aftësi dhe kualifikime për të cilat oferta është e ulët në tregun shqiptar të punës		INSTAT 3	MFE, AKPA, INSTAT, IOM,
	R.3 Krijimi dhe zbatimi i kuadrit rregullator dhe institucional për migracionin e punës		AKPA/ MFE 1	INSTAT
			MASR në konsultim me ministri të tjera të linjës	MSHD, MFE, IOM
C2. Lehtësimi i migracionit sezonal dhe qarkullues për shtetasit shqiptarë	R.1 Të njihen në vazhdimësi dinamikat e migracionit qarkullues dhe sezonal dhe efektiviteti i kuadrit rregullator	18	MFE 9	INSTAT, MB, IOM, MEJP, GIZ, DKM, MSHMS, MSHD, MASR, MBZHR, Organizata të shoqërisë civile AIDA /Fondi Shqiptar për zhvillimin e Diasporës
	R.2 Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar për migracionin e punës		MEJP 5	MFE, AKPA, MSHD, IOM, GIZ, DKM/MB, aktore te tjere.
	R.3 Sigurimi i ofrimit të shërbimeve përpara nisjes për punëtorët migrantë shqiptarë të mundshëm		AKPA 1	MFE
	R.4 Forcimi i kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë		MFE / AKPA 1	DKM/MB, MBZHR, AIDA, Ministri të tjera të linjës Institucione të pushtetit lokal Aktorë të tjerë joqeveritarë
	R.5 Lehtësimi i kthimit dhe riintegrit socio-ekonomik të shtetasve shqiptarë		MASRS 2	MFE, MEJP, MD Koordinatori Shtetëror Komitetit Shtetëror për Diasporën
C3. Maksimizimi i ndikimit të migracionit në zhvillimin kombëtar dhe vendor	R.1 Promovimi i kanaleve formale dhe përdorimi produktiv të remitancave	7	BSH 3	INSTAT Banka Botërore, MEJP Shoqata e bankave Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Shoqata e Bankave AIDA, Autoriteti I Mbikëqyrjes Financiare ALSE, Akademia (universitetet)
	R.2 Promovimi i investimeve në Shqipëri		MFE 2	IOM, AIDA, MSHD, MBZHR
			MEJP 1	
			AIDA 1	MEPJ, INSTAT, MFE, MSHD, MBZHR, IOM
Treguesit e Rezultateve për objektivin strategjik C :	Numri i shtetasve që emigrojnë çdo vit përmes kanaleve të rregullta të migracionit; % rritje e numrit të të kthyerve që përfitojnë mbështetje për riintegrim nga institucionet qeveritare në bashkëpunim me aktorë të tjerë; % rritje e aksesit në shërbimet bankare dhe ato financiare të lidhura me remitancat			

7.

OBJEKTIVI STRATEGJIK D

2022-2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK C

D. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre do të arrihet nëpërmjet realizimit të nënobjektivave specifik si: garantimi i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës e jodiskriminues që mbron në mënyrë të efektshme të drejtat e migrantëve, identifikimi i migrantëve si kategori vulnerabël për programimin dhe ofrimin e asistencës, përmirësimi i kushteve për integrimin kulturor dhe socio-ekonomik të migrantëve, ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për imigrantët.

Kuadri ligjor gjithëpërfshirës e jodiskriminues për të drejtat e të huajve garantohej njësoj si dhe për shtetasit shqiptarë, fillimisht do të arrihet nëpërmjet parashikimeve ligjore e nënligjore që mbrojnë në mënyrë të efektshme të drejtat e migrantëve në të gjithë territorin e RSH-së, por do të realizohet edhe nëpërmjet

ndërgjegjësimit të tyre për këto të drejta, për detyrimet dhe procedurat për zbatimin e tyre. Një nga ceshtjet kryesore të promovimit të mbrojtjes së të drejtave të migrantëve është dhe identifikimi i migrantëve që përfshihen dhe konsiderohen si kategori vulnerabël. Në këtë mënyrë do të jetë më e lehtë të hartohen dhe zbatohen programe të vecanta të ofrimit të asistencës për të përmbushur nevojat e tyre specifike.

Gjithashtu, duke i garantuar migrantëve të drejta të barabartë për sigurime shoqërore, për strehim, kujdes shëndetësor dhe edukim, si dhe duke hartuar dhe zbatuar programe të dedikuara të integrimin, do të ndikohet në përmirësimin më të shpejtë të kushteve të tyre për integrimin kulturor dhe socio-ekonomik, duke i dhënë dhe mundësinë e ofrimit të zgjidhjeve të qëndrueshme sic janë dhe dhënia e statusit të rezidentit apo e shtetësisë shqiptare.

D: Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre				
Nënobjektiva	Rezultate të pritëshme për nënobjektivin	Masa total 34	Lider	Mbështetur
D.1 Garantimi i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës e jodiskriminues që mbron në mënyrë të efektshme të drejtat e migrantëve	R.1 Shtrirja e garancive ligjore të mosdiskriminimit tek të gjithë personat që qëndrojnë në territor R.2 Ndërgjegjësimi i imigrantëve për të drejtat e tyre dhe procedurat për zbatimin e tyre R.3 Përmirësimi i efektivitetit dhe monitorimi i mekanizmave të mbrojtjes	10	MFE 2	MEPJ , MB , AKPA, MFE, Grup Pune Ndërinstitucional
			MB 2	Në bashkëpunim me një Grup Pune Ndërinstitucional, IOM, Shkolla e Magjistraturës , DBE
			MD 1	Klinikat Ligjore Falas që menaxhohen nga organizata të shoqërisë civile
			Të gjitha ministrinë e linjës 1	Avokati i Popullit në Shqipëri Komisioneri Kundër Diskriminimit
			AKPA 1	
			KMD 2	Parlamenti
			Inspektoriati i Punes 1	MFE
D2. Identifikimi i migrantëve si kategori vulnerabël për programimin dhe ofrimin e asistencës	R.1 Përshtatja e asistencës për të përmbushur nevojat specifike të fëmijëve dhe të rinjve R.2 Trajtimi i nevojave specifike të migrantëve	4	MFE 2	AKPA, ISSH, MSHMS, IOM, OJF-të aktive në mbrojtjen e të drejtave të grave
			MSHMB 1	DKM, MB
			MSHMS 1	MB, MD
D3. Përmirësimi i kushteve për integrimin kulturor dhe socio-ekonomik të migrantëve	R.1 Garantimi i të drejtës të barabartë për sigurime shoqërore R.2 Dhënia e të drejtës për strehim, kujdes shëndetësor dhe edukim R.3 Hartimi dhe zbatimimi i programeve të dedikuara të integritit	9	ISSH / MFE 3	INSTAT Banka Botërore, MEPJ Shoqata e bankave Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Shoqata e Bankave AIDA, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ALSE, Akademia (universitetet)
			MSHMS 3	OBSH, MFE, MB, Të gjitha ministrinë e linjës përgjegjëse për zbatimin e këtij Plan Veprimi
			MB 2	MSHMS, MASR, MTM, MK IOM, Avokati i Popullit, Të gjitha ministrinë e linjës përgjegjëse për zbatimin e këtij Plan Veprimi
			ADISA 1	Të gjitha ministrinë e linjës përgjegjëse për zbatimin e këtij Plan Veprimi
D4. Ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për imigrantët	R.1 Lehtësimi i fitimit të qëndrimit afatgjatë dhe qëndrueshmëria e këtij statusi R.2 Ofrimi i një rruge të qartë drejt shtetësisë R.3 Garantimi i statusit ligjor të familjarëve	11	MB 5	MD, MFE, MEPJ, MSHMS, IOM
			DKM / MB 5	
			MFE 1	
Treguesit e Rezultateve për objektivin e strategjik D :	% rritje mes popullatës së migrantëve që tregojnë ndërgjegjësim për të drejtat e tyre dhe kërkojnë zbatimin e legjislacionit; numri i rasteve të shkeljeve kundër punëtorëve të huaj që janë zbuluar dhe hetuar nga autoritetet shtetërore; numri i migrantëve dhe familjarëve të tyre që fitojnë statusin e rezidentit afatgjatë dhe shtetësinë çdo vit.			

8.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

2022-2026

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit dhe Planit të Veprimit, matet nëpërmjet treguesve dhe objektivave të përcaktuara në masat e PV dhe raportimi i rregullt që kryhet nga institucionet udhëheqëse dhe mbështetëse.

Monitorimi në kohe i secilit objektiv/masë të parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2019-2022, ndiqet nga institucioni udhëheqës i strategjisë dhe konkretisht nëpërmjet Sekretariatit Teknik.

Sekretariati Teknik i migracionit ka përcaktuar formatin dhe procedurat e raportimit, si dhe mban komunikime të rregullta e të vazhdueshme me të gjitha institucionet përgjegjëse zbatuese, duke përfshirë si institucionet udhëheqëse ashtu dhe ato mbështetëse.

Çdo institucion udhëheqës, nëpërmjet pikës së kontaktit të caktuar në rrugë zyrtare, është përgjegjës për raportimin e masave përkatëse, duke kontribuar në hartimin e raporteve periodike të strategjisë, të cilat hartohen në afate 3 mujore, 6 mujore dhe 1 vjeçare.

Gjatë hartimit të ketyre raporteve periodike nga institucionet zbatuese, Sekretariati Teknik me qëllim zgjidhjen e problematikave të ndryshme të identifikuara, siguron asistencë teknike për pikat e kontaktit, duke sqaruar metodologjinë e nevojshme për ndjekjen e tyre, referuar dhe mangësive të të dhënave dhe analizën e tendencave të migracionit.

Gjithashtu, Sekretariati Teknik ndjek dhe monitoron gjithë procesin duke u siguruar që ai të jetë gjithëpërfshirës dhe të mbulojë të gjitha objektivat e strategjisë dhe të planit të veprimit.

Në përfundim të mbledhjes së raportimeve, Sekretariati integron të gjitha kontributet e institucioneve udhëheqëse e mbështetëse mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe ja përcjell pikave të kontaktit për konfirmim, ku pas marrjes së konfirmimit, raporti i dorëzohet Komitetit Teknik të Migracionit. Ky komitet është ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 99 datë 27.7.2020, udhëhiqet nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe përbëhet nga Drejtorët e Departamenteve në secilën ministri apo institucion të caktuar me përgjegjësinë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Migracionin.

Raporti përfundimtar, i miratuar nga Komiteti Teknik, përfshin rekomandime të hollësishme, duke trajtuar çështjet e reja në zbatimin e masave të veçanta, i cili më pas i dorëzohet Grupit Drejtues për Migracionin.

Grupi Drejtues për Migracionin është organi konsultativ me funksion mbikëqyrjen e progresit të përgjithshëm në arritjen e objektivave të politikave strategjike të migrimit dhe përmirësimin e mekanizmave të bashkërendimit.

Grupi Drejtues përfshin në përbërjen e tij zëvendësministra, duke përfaqësuar institucionet e përfshira në zbatimin e Strategjisë dhe mbledhet të paktën një herë në vit. Ky grup miraton drejtimet e përgjithshme të aktiviteteve në përmbushjen e Strategjisë, propozon ndryshime të nevojshme të planit të aktiviteteve, harton propozime specifike për rishikimin e fushëveprimit të masave ekzistuese, miraton masat shtesë, si dhe i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandime specifike nga rezultatet e mbledhjeve të tij.

Pikat e kontaktit për raportimet periodike

Nr.	Institution/Agency	Contact point position	Contact: email
1	Banka e Shqipërisë	Përgjegjës Sektori/ Sektori i Përpunimit dhe Publikimit/Departamenti i Statistikave Financiare Kryespecialiste/Sektori i Kërkimit Makroekonomik/ Departamenti i Kërkimeve	<i>rreci@bankofalbania.org</i> <i>lvrioni@bankofalbania.org</i>
2	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	Drejtor i Drejtorisë Juridike	<i>Loreta.Shkempi@ish.gov.al</i>
3	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ASPA	Drejtori i Drejtorisë së Trajnimit të Vazhduar	<i>Adela.Kula@aspa.gov.al</i>
4	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin	Specialiste/Sektori i analizës së rrishtit	<i>ELVIRA.LILA@ASP.gov.al</i>
5	AIDA	Specialist/Drejtorja e Koordinimit	<i>Jerta.Zotaj@aida.gov.al</i>
6	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	Përgjegjëse e Sektorit të Analizës Statistike të Treguesve të Inspektimit	<i>Manjola.Abilekaj@sl.gov.al</i>
7	Ministria e Drejtësisë	Drejtorja e Fizibilitetit të Projekteve Drejtorja e Derregullimit, Licencave dhe Monitorimit	<i>Aljona.mansaku@drejtesia.gov.al</i> <i>Nertila.kaja@drejtesia.gov.al</i>
8	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Specialiste/Drejtorja e Monitorimit Raportimit dhe Komunikimit	<i>esmeralda.sulaj@kmd.al</i>
9	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara ADISA	Specialist/Sektori Përfundim dhe Statistikave/ Drejtorja e Zhvillimit të Shërbimeve	<i>Albiona.Dervishaj@adisa.gov.al</i>
10	Ministria e Financës dhe Ekonomisë Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Specialist	<i>Kostanca.Martini@AKPA.gov.al</i>
11	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Specialist/ Sektori i Çështjeve Konsullore	<i>flutura.nikoci@mfa.gov.al</i>
12	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Përgjegjës Sektori/ Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Specialiste/Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë	<i>Rozalba.Merdani@arsimi.gov.al</i> <i>Nadire.cankja@arsimi.gov.al</i>
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Drejtor/Drejtorja Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës	<i>Alida.Mici@shendetesia.gov.al</i>
14	INSTAT	Përgjegjës i Statistikave të Popullsisë	<i>ocaca@instat.gov.al</i>
15	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Sektori i Politikave të Punësimit dhe Migratore/Drejtorja e Politikave të Punësimit dhe Aftësisë Profesionale	<i>Etleva.Dyrmyshi@financa.gov.al</i>
16	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive AKPA	Drejtor/Drejtorja e Përgjithshme AKPA Specialist/Drejtorja e Përgjithshme AKPA	<i>Anila.bilero@akpa.gov.al</i> <i>Eriona.gaxho@akpa.gov.al</i>

Formati i raportimit

Raporti i Monitorimit te Strategjise Kombetare te Migracionit									
Institucioni Raportues			INSTITUCIONI X						
Periudha e Raportimit			JANAR-DHJETOR 2021						
Numri i Masave per tu raportuar									
Objektivi Specifik A/B/C/D: 'text'									
Nr.1	Masat	Afati kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli I zbatimit				
					E zbatuar	E pazbatuar	Pjeserisht	Ne proces	
1	Raportimi mbi zbatimin e mases :								
	Arsyet e mozbatimit (ne rast kur masa nuk es hte zbatuar)								
	Raportimi Financiar								
	Shpenzimet/Alokimet			Buxheti I shtetit		Donatore		Burime te tjera	
	Shpenzimet financiare (2021)								
Alokimet e pritura (2022)									
Rekomandime:									
Nr.2	Masat	Afati kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli I zbatimit				
					E zbatuar	E pazbatuar	Pjeserisht	Ne proces	
2	Raportimi mbi zbatimin e mases :								
	Arsyet e mozbatimit (ne rast kur masa nuk es hte zbatuar)								
	Raportimi Financiar								
	Shpenzimet/Alokimet			Buxheti I shtetit		Donatore		Burime te tjera	
	Shpenzimet financiare (2021) Alokimet e pritura (2022)								
Rekomandime:									



Implemented by

